



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 112/1 dt.31.07.1995

Këshilli Bashkiak i qytetit Tiranë, pasi shqyrtoi relacionin e Seksionit të Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore “Mbi kalimin e zyrave të Ndërmarrjes së Konservë Makarona në administrim të Ndërmarrjes së Tregut të Lirë”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, neni.14 dhe në VKM Nr.153, dt.03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”,

**VENDOSI**

1. Zyra e Ndërmarrjes së Konservë Makarona, meqënëse kjo është privatizuar, të kalojnë në ambiente zyrash për Ndërmarrjen e Tregut të Lirë.
2. Deri në përfundim të likuidimit të Ndërmarrjes së Konservë Makarona, t’i lihen në dispozicion disa zyra, sipas akt – marrëveshjes së lidhur midis dy ndërmarrjeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Tregtisë dhe Industrisë Ushqimore dhe dy ndërmarrjet përkatëse , Nd.Konservë Makarona dhe N.T.Lirë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**